



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Nr. i Dokumentit: 24.12.1-2017-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË AGJENCISË PËR
MENAXHIMIN E KOMPLEKSEVE MEMORIALE TË KOSOVËS
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2017

Prishtinë, maj 2018

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Valbon Bytyqi i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Udhëheqësja e Ekipit Edona Abazi-Demolli, dhe Anëtares së ekipit Lindita Ajeti, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Faruk Rrahmani.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	11
4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	15
5 Qeverisja e mirë.....	16
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	18
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake.....	21
Shtojca III: Letërkonfirmimi	25

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 25/10/2017.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2017 është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Agjencisë.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson Menaxhmentin e lartë dhe stafin e Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2017 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.*


Theksimi i çështjes

Megjithatë, ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se shpenzimet për mirëmbajtjen e komplekseve memoriale në vlerë 191,377€ janë shpenzuar dhe raportuar gabimisht nga kategoria e investimeve kapitale.

Më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore



Përgjigja e Drejtorit të Përgjithshëm

Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë rekomandimet e dhëna.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshinë ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës (tash e tutje Agjencia). Ne kemi analizuar veprimtarinë e Agjencisë, se deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e Auditorit të Përgjithshëm.

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Gjithashtu merret parasysh edhe deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave (MF).

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin, Nr. 03/L-221, Nr. 04/L-116, Nr. 04/L-194 dhe Ligjin, Nr. 05/L-063), dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se shpenzimet në vlerë totale 191,377€ ishin shpenzuar dhe raportuar gabimisht nga kategoria e investimeve kapitale. Në vijim kemi prezantuar detajet, si:

- Shpenzimet për mirëmbajtjen e komplekseve Memoriale¹, në vlerë 174,710€, të cilat për nga natyra i takonin kategorisë mallra dhe shërbime, ishin buxhetuar dhe shpenzuar gabimisht nga kategoria e investimeve kapitale; dhe
- Shpenzimet lidhur me kontratën "Hartimi i elaboratit të shpronësimit për K.M. Likoshan, Vrellë, Kleçkë dhe Divjakë" në vlerë 16,667€, ishin shpenzuar dhe raportuar gabimisht nga kategoria e investimeve kapitale.

Si pasojë kategoria e investimeve kapitale është mbivlerësuar, në dëm të kategorisë së mallrave dhe shërbimeve. Opinioni jonë nuk është modifikuar (kualifikuar) për këtë çështje.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për PFV

Drejtori i Përgjithshëm është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrollin e brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin, Nr. 03/L-221, Nr. 04/L-116, Nr. 04/L-194 dhe Ligjin, Nr. 05/L-063).

Drejtori i Përgjithshëm është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Agjencisë.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbuloj çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo

¹ K.M "Adem Jashari" - Prekaz; K.M. "Kulla e Zahir Pajazitit" - Podujevë; dhe K.M. "Baza e Parë e UÇK-së" - Podujevë

gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Agjencisë i kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin, Nr. 03/L-221, Nr. 04/L-116, Nr. 04/L-194 dhe Ligjin, Nr. 05/L-063);
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 01/2013 dhe 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK);
- Planin përfundimtar të Prokurimit;
- Kërkesat tjera për raportime buxhetore, siç janë raportet tremujore duke përfshirë edhe pasqyrat nëntëmujore me kohë; dhe
- Raportet për obligimet e papaguara.

Agjencia kishte bërë disa gabime në pasqyrat fillestare e të cilat i kishte korrigjuar brenda afatit ligjor. Korrigjimet ishin bërë në pikat si në vijim:

- *Te neni 18 detyrime kontingjente* – nuk ishin prezantuar detyrimet kontingjente në vlerë 181,890€, ku Agjencia e kishte si kontest gjyqësor për këtë vit; dhe
- *Te neni 19.3.2 pasuritë jo kapitale (nën 1,000€)* – janë prezantuar vetëm blerjet e vitit në vlerë 32,835€, kurse vlera e pasurive të blera nga vitet paraprake nuk ishte regjistruar.

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Ministrinë e Financave, mund të konsiderohet e saktë në të gjitha aspektet materiale, ndonëse ekzistojnë gabime rreth keq-klasifikimit, çështje të cilën e kemi elaboruar gjerësisht te theksimi i çështjes të opinionit të auditimit.

Sa i përket kërkesave tjera të raportimit, Agjencia ka arritur të dorëzoj me kohë të gjitha raportet të cilat kërkohen me kornizën e aplikueshme ligjore.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Për çështjet e sipërpërmendura me lartë ne japim rekomandimin si në vijim:

Rekomandimi 1 Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes, duke marrë veprime specifike për t'i eliminuar gabimet në klasifikimin e shpenzimeve. Në këtë aspekt, të ndërmerren veprimet e duhura që të gjitha shpenzimet të planifikohen, evidentohen dhe raportohen drejtë në kategoritë përkatëse të tyre në përputhje me planin kontabël; dhe

Gjithashtu, Drejtori i Përgjithshëm, duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2018 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo, po ashtu, duhet të përfshijë rishikimin e PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë lidhur me MFK-në, pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i buxhetit, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore, pasuritë, si dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Agjencia në vitin 2017 kishte një performancë të mirë buxhetore. Në kontest të sistemeve financiare, kontrollet mbi shpenzimet në përgjithësi janë të mira, me përjashtim të disa çështjeve të cilat kërkojnë një vëmendje më të madhe. Fushat kryesore ku nevojiten përmirësime të mëtejme kanë të bëjnë me menaxhimin më të mirë të projekteve duke eliminuar dukurinë e punëve shtesë, si dhe funksionalizimin e sistemit e-pasuria dhe përdorimi i tij për menaxhimin e pasurive jo kapitale.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore, si dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Burimet e Fondeve:	3,911,878	3,231,839	3,175,882	1,940,711	1,811,343
Granti i Qeverisë -Buxheti	3,911,878	3,231,839	3,175,882	1,940,711	1,811,343

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 680,039€. Ky zvogëlim ishte bërë me rishikim të buxhetit dhe në pajtim me vendimet e Qeverisë.

Në vitin 2017, Agjencia ka shpenzuar 98% të buxhetit final ose 3,175,882€, me një trend të njëjtë të realizimit me vitin 2016. Prandaj, realizimi i buxhetit edhe këtë vit është në nivel të kënaqshëm, dhe më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

² Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	3,911,878	3,231,839	3,175,882	1,940,711	1,811,343
Pagat dhe Mëditjet	87,007	86,879	86,600	81,340	74,519
Mallrat dhe Shërbimet	44,871	65,034	53,351	34,650	40,879
Shërbimet komunale	30,000	30,000	30,000	29,169	27,953
Investimet Kapitale	3,750,000	3,049,926	3,005,931	1,795,552	1,667,992

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Buxheti për kategorinë e mallrave dhe shërbimeve është realizuar në nivelin 82%. Kjo performancë është ndikuar nga furnizimet më të vogla si rezultat i vonesave në proceset e prokurimit dhe kursimeve të fondeve për udhëtime zyrtare, pasi që një pjesë e këtyre udhëtimeve nuk ishin realizuar; dhe
- Sa i përket kategorisë së shpenzimeve kapitale, kishte një zvogëlim të buxhetit final nga ai fillestar për 700,075€. Arsyeja e zvogëlimit të buxhetit final nga ai fillestar, ishte marrja e vendimit të Qeverisë nr. 08/151 me datë 02.08.2017, ku me këtë vendim Agjencisë i janë reduktuar alokimet me 1,070,000€. Kjo kishte ndodhur për shkak se kishte vonesa në realizimin e procedurave të prokurimit. Megjithatë me një vendim tjetër të Qeverisë nr.01/19 me datë 15.12.2017, për këtë kategori janë alokuar mjete prej 400,000€, për shkak të obligimeve të Agjencisë ndaj furnitorëve. Realizimi i shpenzimeve kapitale krahas asaj të buxhetuar është 99%.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.2 Pagat dhe shtesat

Pagat dhe shtesat paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga Ministria e Administratës Publike (MAP) dhe MF. Sipas shënimeve të SIMFK-së, buxheti për kategorinë e Pagave dhe Mëditjeve ishte 86,879€, ndërsa realizimi i shpenzimeve ishte 86,600€. Numri i planifikuar dhe aktual për vitin 2017 ishte 12.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime, duke përfshirë shërbimet komunale në vitin 2017 ishte 95,034€. Prej tyre ishin shpenzuar 83,351€. Ne kemi rishikuar proceset e blerjes së mallrave apo shërbimeve të pranuar, duke përfshirë edhe procedurat e prokurimit. Nga këto testime, vlerësojmë se Agjencia kishte arritur të zbatojë kërkesat ligjore, qofshin financiare apo ato të prokurimit.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.4 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 3,049,925€. Prej tyre në 2017 ishin shpenzuar 3,005,931€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me ndërtimin, konzervimin dhe restaurimin e Komplekseve Memoriale, si dhe realizimin e skulpturave.

Çështja 2 – Punët shtesë jashtë kontratës bazë si dukuri

E gjetura Për pesë projekte: K.M 'Dëshmorët e UCK-së', Penuhë, K.M 'Masakra e Raqakut', K.M '27 Prilli', Gjakovë, K.M 'Varrezat e Dëshmorëve të UÇK-së', Marinë dhe K.M 'Dëshmorët e Kombit' Vrellë, ishin kontraktuar punë shtesë me vlerë prej 170,203€. Kjo kishte ndodhur si rezultat i mangësive që kanë projektet dhe projekttimeve jo të analizuar mirë për ndërtimin e komplekseve. Punët shtesë janë arsyetuar nga menaxheri i kontratës dhe lejohen edhe me ligj, megjithatë vërehet se është bërë dukuri e shpeshtë, dhe po përsëritet nëpër vite.

Rreziku Planifikimet jo të mira të projekteve rezultojnë me nevojën për ndryshime në projekte, e që kjo reflekton në krijimin e kostove shtesë. Si rezultat i kësaj, këto punë shtesë i rrezikojnë fondet e ndara për projekte tjera duke pamundësuar financimin e projekteve të reja.

Rekomandimi 2 Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë që të gjitha projektet e planifikuara të jenë të hartuara dhe të detajuara mirë. Para hartimit të projekteve është e nevojshme që projektuesit të vizitojnë vend-ndërtimet, në mënyrë që të bëhen vlerësimet e nevojshme konform standardeve specifike të këtyre ndërtimeve. Kjo do të shmangte fillimin e projekteve jo cilësore dhe do të evitonte nevojën për punë shtesë.

3.5 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Sipas PFV-ve, vlera neto e pasurisë kapitale të Agjencisë ishte 6,663,173€, ndërsa vlera e pasurisë jokapitale ishte 65,512 €, dhe vlera e stoqeve ishte 2,072€.

Edhe më tej mbetet sfida për Agjencinë aplikimi i sistemit e-pasuria, për evidentimin dhe menaxhimin e pasurive me vlerë nën 1,000€ dhe stoqeve. Mungesa e këtij sistemi dhe mos llogaritja e zhvlerësimit po ndikon në mbivlerësimin e këtyre pasurive në PFV.

Ne kemi rishikuar nëse procesi i regjistrimit dhe mënyra e mbajtjes së evidencave është në pajtueshmëri me kërkesat e rregullës së MF-Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore, procesin e inventarizimit, zhvlerësimin dhe ekzistencën fizike të pasurive.

Çështja 3 - Mos funksionalizimi i sistemit e-pasuria

E gjetura Rregullorja nr. 02/2013 thekson se pasuritë kapitale duhet të regjistrohen në regjistrin kontabël - SIMFK ndërsa pasuritë jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin “e - pasuria”.

Agjencia, ende nuk e ka në funksion programin qeveritar e-pasuria, përkundër që kishte bërë shkresa zyrtare në MAP për funksionalizimin e këtij sistemi. Në mungesë të këtij sistemi, regjistri i pasurisë me vlerë nën 1,000€ është duke u mbajtur në një formë të Exel-it, ku ekziston mundësia e ndryshimeve në çdo kohë dhe pa lënë gjurmë.

Rreziku Mos funksionalizimi i sistemit e-pasuria, vështirëson menaxhimin adekuat të pasurisë dhe rrit rrezikun e gabimeve gjatë evidentimit të pasurisë si dhe përlllogaritjes manuale të zhvlerësimit. Po ashtu, kjo mund të rezultojë me mos përmbushje të kërkesave të kontabilitetit dhe raportimit financiar të pasurisë.

Rekomandimi 3 Drejtori i Përgjithshëm duhet të marrë veprimet e nevojshme për ta aplikuar sistemin e menaxhimit të pasurisë (e-pasuria), në mënyrë që menaxhimi dhe raportimi i pasurisë të bëhet në përputhje me kërkesat e rregullores për menaxhimin e pasurisë jo financiare. Me pas të sigurohen trajnimet e duhura për stafin e Agjencisë të cilët do të përcaktohen përgjegjës për zbatimin e këtij sistemi.

3.6 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2017 ishte 35,004€, prej tyre 780€ ishin obligime të papaguara nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve, 6,663€ për shërbime komunale, si dhe 27,561€ për investime kapitale. Të gjitha këto janë fatura të pranuar gjatë muajit dhjetor dhe muajit janar 2018, për shërbimet dhe ndërtimet e pranuar për vitin 2017. Agjencia kishte raportuar në baza të rregullta mujore për obligimet e papaguara gjatë viti 2017.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e Agjencisë për vitin 2016, ka rezultuar me tetë rekomandime kryesore. Menaxhmenti i Agjencisë ka ndërmarrë veprime për t'i adresuar çështjet e ngritura, megjithëse ende mbetet sfida zbatimi i plotë i tyre.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2017, dy rekomandime janë zbatuar, dy janë në proces të zbatimit, ndërsa katër nuk janë zbatuar ende. Po ashtu, nga viti 2015 ishin bartur tetë rekomandime prej të cilave, dy janë zbatuar, tri janë në proces të zbatimit, kurse tri rekomandime mbeten të pazbatuara edhe këtë vit.

Një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato shihni Shtojcën II.

Çështja 4 – Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve të viteve paraprake

- | | |
|----------------------|---|
| E gjetura | Edhe përkundër progresit dhe angazhimit të menaxhmentit për të zbatuar rekomandimet e dhëna, një numër i konsiderueshëm i tyre kanë mbete në proces të zbatimit ose të pazbatuara. Këto rekomandime kanë të bëjnë me keq-klasifikimin e shpenzimeve (për të cilin është theksuar çështja), dinamikë e ngadalshme në realizimin e buxhetit për investime kapitale, dhe kontraktimi për punë shtesë jashtë kontratave bazë. |
| Rreziku | Mos zbatimi i plotë i rekomandimeve rritë rrezikun e pranisë së vazhdueshme të mangësive të njëjta dhe mund të rezultojë në mos efikasitet të vazhdueshëm të kontrolleve, dhe vështirësi në përmbushjen e objektivave. |
| Rekomandimi 4 | Drejtori i Përgjithshëm duhet të rishikoj dhe analizoj shkaqet e rekomandimeve të pazbatuara duke siguruar që zbatimi i planit të veprimit, monitorohet në vazhdimësi dhe raportohet në baza të rregullta mujore ose tre mujore në lidhje me progresin e arritur në këtë drejtim. Rekomandimet të cilat nuk ishin zbatuar, të rishikohen në një afat të shkurtër, si dhe të ndërmerren veprime pro-aktive ndaj barrierave të paraqitura gjatë zbatimit. |

5 Qeverisja e mirë

Hyrje

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimit e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA-së me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i një pjese të madhe të rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmer veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK-në nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i pyetësorëve të vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen MF-së.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentat tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Agjencia në përgjithësi ka kontrolle të mira në raport me obligimet ligjore të saj. Menaxhimi financiar dhe kontrolli ka dëshmuar proces të mirë të rishikimit dhe siguri në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve të tjera të kontrollit.

Agjencia kishte përgatitur me kohë planin për zbatimin e rekomandimeve, si dhe kishte arritur të zbatoj një pjesë të tyre. Po ashtu, ka përgatitur regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat, duke identifikuar të gjitha rreziqet domethënëse që mund të kenë ndikim tek organizata në lidhje me arritjen e objektivave të saj. Këtij regjistri i bashkëngjitet edhe monitorimi formal, për të cilin menaxhmenti e kishte realizuar.

Megjithëse, në kuadër të qeverisjes lidhur me aktivitetet operacionale dhe financiare ende mbetin fusha brenda Agjencisë të cilat kërkojnë të përmirësohen, veçanërisht në lidhje me azhurnimin e regjistrit të rreziqeve dhe përgatitjen e Planit Strategjik.

5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Sipas UA Nr. 23/2009 për themelimin dhe funksionimin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm, Agjencia nuk i plotëson kriteret për themelimin e kësaj njësie.

Rekomandime

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, megjithatë menaxhimi dhe azhurnimi i regjistrit të rreziqeve mbetet ende çështje e cila duhet përmirësuar tutje.

Çështja 5 - Dobësi në menaxhimin e regjistrit të rreziqeve dhe mungesa e planit strategjik

- E gjetura** Sipas rregullave të MFK-së, Agjencia ka krijuar procedura formale dhe të dokumentuara të vlerësimit, menaxhimit dhe monitorimit të rreziqeve. Megjithatë edhe pse regjistri i rreziqeve është hartuar, ai nuk është menaxhuar në mënyrë aktive për sa i përket azhurnimit dhe sigurimit se janë ndërmarrë veprime për të parandaluar dhe zbutur rreziqet. Po ashtu, plani strategjik ende nuk ishte hartuar deri në fund të auditimit tonë.
- Rreziku** Mungesa e menaxhimit të rrezikut dhe planit strategjik do të dobësoj cilësinë e shërbimit ndaj qytetarëve nëse çështjet e brendshme dhe të jashtme që ndikojnë në këtë, nuk adresohen në kohën e duhur. Kjo për shkak se veprimet pro aktive të nevojshme për të parandaluar ose evituar ndikimin e çështjeve të tilla nuk do të ndërmerren në mënyrë të planifikuar dhe sistematike.
- Rekomandimi 5** Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë hartimin e planit strategjik dhe të sigurojë azhurnim efektiv dhe raportim tremujor të rreziqeve për zbatimin e kërkesave në këtë fushë.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të dy viteve paraprake

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e bartura nga viti 2015	Të zbatuara gjatë vitit 2017	Në proces të zbatimit gjatë 2017	Të pa zbatuara
1.3 Rreziqet domethënëse në Pasqyrat Vjetore Financiare	Drejtori i AMKMK-së duhet të sigurojë fillimisht klasifikimin korrekt të shpenzimeve në buxhet në mënyrë që shpenzimet të mund të realizohen dhe të regjistrohen në kategoritë buxhetore adekuate. Kjo mundëson paraqitje me të qartë lidhur me natyrën e shpenzimeve të realizuara dhe të prezantuara në PVF.			Nuk janë marrë masa.
2.3 Rekomandimet e vitit paraparak	Drejtori i AMKMK-së duhet të sigurojë që plani i veprimit, i rishikuar, të përcaktojë saktë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e rekomandimeve që nuk janë implementuar dhe atyre të pa adresuara.		Rekomandimi për keqklasifikimin e shpenzimeve të mirëmbajtjes së komplekseve dhe dukuria e punëve shtesë ishin përsëritur edhe në këtë vit.	
2.4 Lista kontrolluese e vetvlerësimit	Drejtori i AMKMK-së duhet të iniciojë sa më parë hartimin e një strategjie gjithëpërfshirëse të institucionit, përfshirë planin për menaxhimin e rreziqeve potenciale që do të kërcënonin arritjen e objektivave të synuara. Po ashtu duhet të zbatohet një proces efikas për plotësimin e listës kontrolluese të vetvlerësimit dhe të bëhet adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive.		Në proces të zbatimit.	

2.5 Rishikimet specifike të qeverisjes	Drejtori i AMKMK-së duhet të sigurojë vendosjen e një procesi adekuat për menaxhimin e rrezikut. Ky proces duhet të përfshijë hartimin e një liste të rreziqeve potenciale së bashku me masat e nevojshme për menaxhimin e tyre, si dhe të sigurojë raportim mujor për zbatimin e kërkesave në këtë fushë.		Në proces të zbatimit - lista e rreziqeve është përgatitur dhe monitoruar në fillim të vitit 2018, mirëpo kjo listë nuk ishte azhurnuar gjatë vitit.	
3.3 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit	Drejtori i AMKMK-së duhet të monitorojë performancën buxhetore dhe realizimin e projekteve në baza mujore dhe të identifikojë dhe adresojë me kohë barrierat në dinamikën e realizimit të buxhetit.			Nuk janë marrë masa.
3.4 Prokurimi	Drejtori i AMKMK-së duhet të sigurojë që të gjitha projektet e planifikuara të jenë të hartuara mirë dhe të detajuara. Para hartimit të projekteve është e nevojshme që projektuesit të vizitojnë lokacionet ku do të ndërtohen ato, dhe të bëhen matjet e nevojshme konform standardeve të ndërtimit. Kjo do të shmangte fillimin e projekteve jo cilësore dhe do të evitonte kostot shtesë eventuale.			Nuk janë marrë masa.
Komponenta e auditimit	Rekomandimet e dhëna në vitin 2016			
1.3 Rekomandimet për theksimin e çështjes	Drejtori duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksimin e Çështjes. Fillimisht duhet bërë klasifikimin korrekt të shpenzimeve në buxhet në mënyrë që shpenzimet të mund të realizohen dhe regjistrohen në kategoritë buxhetore adekuate. Po ashtu duhet siguruar që shpenzimet e mirëmbajtjes të mos regjistrohen në regjistrin e pasurive pasi që ato nuk mund të trajtohen si pasuri.			Nuk janë marrë masa.

2.1 Rekomandimet e vitit paraprak	Drejtori i AMKMK-së duhet të sigurojë që është zbatuar plani i veprimit, i rishikuar, i cili i përcakton saktë afatet kohore për zbatimin e rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në rekomandimet me prioritet të lartë.		Në proces të zbatimit.	
2.2 Pyetësi i vetëvlerësimit	Drejtori i AMKMK-së duhet të iniciojë sa më parë hartimin e një strategjie gjithëpërfshirëse të institucionit, e cila do t'i paraprinte proceseve tjera siç është menaxhimi i rreziqeve. Përveç kësaj monitorimi dhe raportimi mbi planin për menaxhimin e rreziqeve duhet të bëhet në baza të rregullta kohore.		Plani Strategjik edhe për vitin 2017 nuk ishte përgatitur, kurse monitorimi i rreziqeve kishte filluar të aplikohet. Mbetet sfidë azhurnimi i këtij regjistri.	
3.1 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit	Drejtori i AMKMK-së duhet të monitorojë performancën buxhetore dhe realizimin e projekteve në baza mujore si dhe të identifikojë dhe adresojë me kohë barrierat në dinamikën e realizimit të buxhetit.			Nuk janë marrë masa.
3.1.1 Pagat dhe Mëditjet	Drejtori i AMKMK-së duhet të gjejë alternativa që t'i plotësojë pozitat me zyrtarë permanent për certifikim dhe për menaxhim të pasurisë. Në të kundërt duhet të diskutojë me ndonjë institucion të pavarur për mundësinë e shfrytëzimit të përbashkët të shërbimeve për certifikimin e pagesave dhe menaxhimin e regjistrave të pasurive, ose caktimi i punëve shtesë të shoqërohet me vendime për punën shtesë.			Nuk janë marrë masa.
3.1.2 Mallra dhe Shërbime	Drejtori i AMKMK-së duhet të sigurojë që të gjitha mallrat dhe shërbimet të pranohen nga komisioni i caktuar i përbërë nga tre vetë. Kjo siguron që mallrat dhe shërbimet të jenë cilësore dhe në harmoni me kontratat.	Po		
3.1.3 Investimet Kapitale	Drejtori i AMKMK-së duhet të sigurojë që në të ardhmen të mos ndodhin pagesa në kundërshtim me dispozitat e legjisllacionit dhe rregullave financiare.	Po		

	<p>Drejtori i AMKMK-së duhet të sigurojë që të gjitha projektet e planifikuara të jenë të hartuara mirë dhe të detajuara. Para hartimit të projekteve është e nevojshme që projektuesit të vizitojnë vend-ndërtimet, në mënyrë që të bëhen matjet e nevojshme konform standardeve të ndërtimit. Kjo do të shmangte fillimin e projekteve jo cilësore dhe do të evitonte kostot shtesë eventuale.</p>			<p>Nuk janë marrë masa.</p>
--	--	--	--	-----------------------------

Shtojca III: Letërkonfirmimi



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
 Agjencia Për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës
 Agencija sa Upravljanje Memorialnih Kompleksa Kosova
 Agency on Management of Memorial of the Complexes of Kosovo

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2017 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. Idriz Blakaj, Drejtor i Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale

Data: 25. Prill.2018, Prishtinë,

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE I NATIONAL AUDIT OFFICE			
DIREKTORIT/PROJEKTORIT ZYRËS PËR MENAXHIMIN E KOMPLEKSEVE MEMORIALE DISTR. KOMBËTARE SUBJECTS:			
25.04.2018			
Niveli Org. Org. Jedin. Org. Unit	Shif. Klasif. Classif. Kod Class. Code	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Nr. Stronice Sr. Stronice No. Pages
05	401	558	1